



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:017209

Datë: 23.06.2020

Numri i dokumentit: 00988320

PKR.nr.101/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TE RENDA, si gjykatë e shkallës së parë me kryetarin e trupit gjykues Sahit Krasniqi, gjyqtaret profesional Mirlinda Bytyqi- Rexhepi dhe Ibrahim Idrizi– anëtar të trupit gjykues dhe zyrtaren ligjore Gentiana Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit K.S.1 për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-se, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.I.nr.98/17 të dt. 20.07.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 23.06.2020, në praninë e Prokurorit të shtetit Veton Shabani, të pandehurit K.S.1, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

K.S.1 i lindur me dt. ... në fshatin ... Komuna Shtime, nga I ati Sh... dhe e ëma M... e vajzërisë P..., me vendbanim në Ferizaj rr..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme të mjeksis, i pa martuar, i punësuar në Shtëpinë e shëndetit në cilësinë e Teknikut Mrdicinal, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal

Konformë nenit 363 par. 1 nën par.1.1 të KPPRK-së .

REFUZOHET AKUZA

Sepse: me date 13.06.2017 rreth orës 22:25, në Shtime rr..., ne qantën e krahut e të pandehurit, gjatë kontrollit nga ana e zyrtareve policor është gjetur pistoleta e tipit Ecol Special me numër serik EV 1422414 e cal 9 mm, te cilën armë e ka poseduar pa autorizim dhe ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët ne Kosovë

- për shkak se Prokurori Shtetit është tërhequr nga akuza në shqyrtimin gjyqësor.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP.I.nr. 98/2017 të dt. 20.07.2017 ka ngarkuar të pandehurit: K.S.1 për shkak te veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se

Gjykata Themelore ne Ferizaj – Departamenti për Krime te Renda caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me dt. 27.12.2017 ne te cilin shqyrtim i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë per veprën penale me te cilën e ngarkon aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, me pas me dt. 23.06.2020 gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ne cilin shqyrtim ju dha mundësia edhe një here te pandehurit për pranimin apo mos pranimin fajësisë e ne te cilin shqyrtim i njëjti deklaroi se nuk e pranon fajësinë me arsyetimin se nuk e ka kryer veprën penale mirëpo këtë vepër e ka kryer vëllai i tij K.S.2 dhe te njëjtin e propozon qe te dëgjohet si dëshmitar ku edhe është prezentë.

Gjykata pas marrjes se mendimit edhe nga Prokurori i Shtetit ka vendosur qe ne cilësinë e dëshmitarit te dëgjoj vëllain e te pandehurit K.S.2, i cili deklaroi se veprën e kishte kryer ai dhe se ne te njëjtën ditë të përshkruar si ne dispozitiv te aktakuzës është takuar nga policia dhe se te njëjtit iu është gjetur arma e lartcekur, mirëpo pasi qe me vete kishte letërnjoftimin e

vëllait K.S.1, ai është paraqitur me emër të K.S.1 dhe jo me emrin e tij të vërtetë, andaj deklaron me përgjegjësi të plote se këtë vepër e ka kryer ai dhe jo vëllai i tij K.S.1.

Prokurori i Shtetit pas dëgjimit të dëshmitarit ka deklaruar se tërhiqet nga aktakuza kundër të pandehurit K.S.1.

Pasi që Prokurori i Shtetit është tërhequr nga aktakuza kundër të pandehurit K.S.1, gjykata në bazë të nen. 363 par.1 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrur konform nen. 454 par.1. të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA
PKR.nr.101/17, të dt. 23.06.2020

Zyrtare Ligjore:

Gentiana Hoxha

Kryetari i trupit gjykues

Sahit Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit.